

Prof. dr. Fehmi REXHEPI

**STUDIM GJITHPËRFSHIRËS MBI QËNDRIMIN E
DIPLOMACISË BRITANIKE NDAJ
ÇËSHTJES SHQIPTARE**

*Dr. Frashër DEMAJ, Britania e Madhe dhe Çështja Shqiptare
1875-1913, Instituti i Historisë - Prishtinë*

Në historiografinë shqiptare gjithnjë e më shumë po i kushtohet vëmendje marrëdhënieve të shqiptarëve me popujt dhe qeveritë e vendeve të Evropës të cilat drejtpërdrejt ose tërthorazi ishin të implikuara në përcaktimin e fatit historik të popullit tonë. Rol shumë të rëndësishëm sidomos gjatë shekullit XIX dhe fillim shekullit XX kishte diplomacia e Britanisë së Madhe si një ndër Fuqitë e Mëdha të kohës. Pikërisht qëndrimi i diplomacisë angleze ndaj çështjes shqiptare është fusha e interesimeve shkencore që trajton Prof. dr. Frashër Demaj në studimin monografik "Britania e Madhe dhe çështja shqiptare 1875-1913", botim i Institutit të Historisë në Prishtinë.

Kjo monografi është pa dyshim studim i parë serioz që trajton gjithanshëm qëndrimin e diplomacisë britanike ndaj çështjes shqiptare në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX, pra në një periudhë shumë të rëndësishme të historisë sonë – në atë të Rilindjes Kombëtare. Studimi ka gjithsej 331 faqe tekst të sistemuar në: parathënie, hyrje, shtatë kapituj, përfundime, burimet arkivore, dokumentet e botuara, gazetatat dhe revistat si dhe literaturën e shfrytëzuar.

Në parathënie dhe hyrje, autori shpjegon motivin që e ka shtyrë të merret me këtë temë sa të rëndësishme aq edhe me përgjegjësi. Monografia paraqet interes shumëdimensional për studimet shqiptare në përgjithësi dhe për ato që janë të lidhura me aspektet ndërkombëtare të raporteve britanike – shqiptare në veçanti, e që e plotësojnë mozaikun e historisë së popullit shqiptar të kësaj periudhe.

Në kapitullin e parë "POLITIKA E BRITANISË SË MADHE NDAJ SHQIPTARËVE DHE BALLKANIT 1875-1878" autori konstaton se Qeveria e Britanisë së Madhe me përkrahjen e Traktatit të Paqes së Parisit u bë garantë e tërësisë territoriale dhe pavarësisë së Perandorisë Osmane, pra për politikën britanike me rëndësi ishte mbrojtja e interesave të saj e jo e drejta e popujve për çlirim.

Me fillimin e luftës ruso-turke në vitin 1877 qeveria britanike u deklarua se do të qëndronte neutrale për aq kohë sa nuk do të cenoheshin interesat britanike. Mirëpo ky “neutralitet” i qeverisë britanike nuk zgjati shumë sepse në momentin kur ushtria ruse po marshonte drejt Edrenes, qeveria britanike më 23 janar 1878 urdhëroi Flotën e Britanisë së Madhe që të nisej drejt Stambollit.

Për Krizën Lindore, autori konstaton se është ndër ngjarjet më të rëndësishme të gjysmës së dytë të shekullit XIX ku njëri ndër faktorët më të rëndësishëm dhe më përcaktues në vijimin e ngjarjeve ishte pa dyshim Britania e Madhe. Për shqiptarët, autori konstaton me të drejtë se ata dolën jo si ndonjë faktor i rëndësishëm që ndikoi në shfaqjen apo shuarjen e krizës, por si pjesë e përgjithshme e kësaj krize, ku implikoheshin interesat e Fuqive të Mëdha, por edhe interesat e shteteve fqinjë.

Një kapitull i veçantë i kushtohet QËNDRIMIT të BRITANISË SË MADHE NDAJ TRAKTATIT TË SHËN STEFANIT, ku potencohet fakti se Traktati tregonte qartë se Perandoria Ruse vazhdonte ta trajtonte Shqipërinë si një tokë turke, për t’u ndarë midis aleatëve të saj në Ballkan.

Ideja e formimit të shtetit shqiptar nga disa atdhetarë të Komitetit të Stambollit, mbeti e pareaizuar edhe për faktin se diplomacia britanike nuk e pranoi shembjen e Perandorisë osmane.

Në këtë kapitull trajtohen Mospajtimet e qeverisë britanike me marrëveshjen ruso-turke dhe kërkesa për organizimin e një konference ndërkombëtare ku cenohet rëndë integriteti territorial i Perandorisë Osmane e në këtë kuadër edhe i viseve shqiptare.

Në kapitullin e tretë QËNDRIMI I BRITANISË SË MADHE NDAJ LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT trajtohet Lidhja Shqiptare e Prizrenit nga prizmi i diplomacisë britanike ku vihet në pah interesimi i veçantë i diplomacisë britanike për zhvillimet politike në trojet shqiptare sidomos në prag të ngjarjeve që u zhvilluan para dhe gjatë Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Autori me të drejtë konstaton se rol shumë të rëndësishëm në krijimin e opinionit dhe marrjen e vendimeve nga qeveria britanike kishin përfaqësitë konsullore dhe instanca tjera diplomatike të akredituara në terren. Një rol shumë domethënës në periudhën në mes viteve 1878-1881 në krijimin e opinionit politik për shqiptarët patën Konsullatat britanike në Prizren, në Shkodër, në Manastir, në Janinë, në Prevezë, në Shkup, në Larisa, në Sofje, në Selanik si dhe ambasada britanike në Stamboll. Ndër konsujt më aktiv në Prizren nga të gjitha përfaqësitë diplomatike të Fuqive të Mëdha njihej britaniku Seint Gjon (St. John).

Edhe diplomati britanik Kirbi Grin (Kirby Green), sikur edhe konsuj dhe diplomatë tjerë vinin në Shqipëri pa ndonjë njohje të thellë dhe përplot paragjykime për popullin shqiptar, sidomos kur i identifikonin ata mbi baza fetare e ndonjëherë edhe si turq-osman.

Autori duke trajtuar Memorandumet, peticionet, kërkesat dhe protestat e shqiptarëve drejtuar qeverisë britanike flet për përpjekjet e vazhdueshme të shqiptarëve për çlirim, krijimin e shtetit kombëtar, luftën për mbrojtjen e kufijve, dërgimin e peticioneve, protestave të shumta, memorandumeve, kërkesave dhe akteve tjera me karakter politik dërguar Britanisë së Madhe dhe Fuqive të tjera.

Më pas autori trajton Misionin diplomatik të Abdyl Frashrit dhe Mehmet Vrionit në Evropë. Delegacioni shqiptar kishte vendosur të vizitonte Romën, Parisin, Londrën, Berlinin, Vjenën dhe më në fund Stambollin. Pas një udhëtimi të gjatë dhe të mundimshëm më 8 maj 1879 delegacioni shqiptar arriti në Londër.

Shefi i diplomacisë angleze druante se takimi me Abdyl Frashërin dhe Mehmet Ali Vrionin në Forin Ofis, mund të interpretohej nga Porta e Lartë si një njohje de facto e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit nga ana e Londrës, gjë që mund të shkaktoje reagime nga Stambolli. Megjithatë Sollsberi nuk mundi ta "fsheh" interesimin e tij për të takuar dhe për të biseduar me delegacionin shqiptar. Ai u shpreh i gatshëm t'i pranonte dy delegatët shqiptarë, privatisht, në shtëpinë e tij dhe të bisedonte me ta.

Në kapitullin e katërt trajtohet në mënyrë analitike KONGRESI I BERLINIT DHE ÇËSHTJA SHQIPTARE.

Shikuar në tërësi, sipas autorit, Kongresi i Berlinit arriti të zhvlerësonte Traktatin e Shën Stefanit që u imponua nga fitorja e Rusisë ndaj Perandorisë Osmane. Shqiptarët u dëmtuan rëndë nga përmbajtja e këtij Traktati. Britania nuk i përkrahu kërkesat e tyre. Ajo nuk e pranoi autonominë e Shqipërisë për faktin se ishte aleate dhe përkrahëse tradicionale e Perandorisë Osmane dhe statusquosë në Ballkan.

Trajtimi i RRETHANAVE POLITIKE NË BALLKAN DHE QËNDRIMI I BRITANISË SË MADHE NDAJ LËVIZJES KOMBËTARE SHQIPTARE 1881-1889 fillon me pozitën e shqiptarëve pas shuarjes së Lidhjes së Prizrenit si dhe me qëndrimin e Britanisë ndaj tyre.

Vend të veçantë autori i kushton formimit të Lidhjes Shqiptare të Pejës dhe reagimit të diplomacisë britanike ndaj kësaj ngjarje madhore të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.

Si edhe më parë, shumë diplomatët britanik edhe në këtë kohë me ose pa dashje e ngatërronin fenë me kërkesat kombëtare të shqiptarëve dhe çdo aktivitet dhe lëvizje kryengritëse e trajtonin si kërkesë "për një jetë më të mirë" në kuadër të Perandorisë Osmane e jo si kërkesa dhe aktivitete me qëllime kombëtare.

Në Kapitullin e gjashtë RRETHANAT NDERKOMBËTARE DHE QËNDRIMI I BRITANISË SË MADHE NDAJ SHQIPTARËVE 1900-1912 flitet për Rrethanat në Shqipëri, rivalitetin italo-austrohungarez dhe prezencën britanike në viset shqiptare. Aty trajtohet kriza që po përjetonte sundimi osman në Shqipëri. Avancimi i mendimit politik të qarqeve diplomatike britanike për kërkesat e shqiptarëve kishte ardhur si rezultat i aktiviteteve të paseshura diplomatike të politikanëve dhe diplomatëve shqiptarë si Ismail Qemali, Faik Konica, Ibrahim Temo e të tjerë.

Reagimi i Britanisë së Madhe ndaj kryengritjeve shqiptare 1910-1911 ishte në përputhje me qëndrimin e saj për shqiptarët dhe Ballkanin. Britanikët i tërhiqnin vërejtjen Stambollit që të mos nxiste dhunë dhe konflikte në një kohë shumë të papërshtatshme për Perandorinë pasi që shtetet ballkanike mezi prisnin eskalimin e situatës dhe hyrjen në luftë kundër osmanëve.

Udhëheqësit e Lëvizjes Kombëtare bënë përpjekje për të siguruar edhe mbështetjen e Fuqive të Mëdha, mirëpo, asnjëra nga këto Fuqi nuk tregoi gatishmëri për ta mbështetur autonominë e Shqipërisë me anë të luftës së armatosur.

Hasan Prishtina u përpoq të përfitonte mbështetjen e Britanisë së Madhe, prandaj për këtë qëllim u takua me konsullin anglez në Shkup, z. Pekham. Konsulli britanik u shpreh se parapëlqente idenë e kryengritjes, por përgjigjja do të vinte pasi do të merrte mendimin e qeverisë së tij në Londër. Ai nuk mund të bënte ndonjë deklaram publik që nuk ishte i sigurt se ishte në përputhje me politikën e jashtme që ndiqte qeveria britanike. Ndërkaq, Ministria e Punëve të Jashtme do ti urdhërojë Pekhamit “që të mos i jepte kurrfarë përkrahje Hasan Prishtinës për plotësimin e këtyre aspiratave”.

SHPALLJA E PAVARËSISË SË SHQIPËRISË DHE REAGIMI I DIPLOMACISË BRITANIKE është kapitulli i fundit i këtij punimi monografik që fillon me nëntitullin Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë.

Në këtë kohë diplomacia e Fuqive të Mëdha ishte vënë në veprim dhe kërkonte zgjidhje për situata të ndryshme të cilat kishin mbetur nyje si rezultat i përbaljes dhe interesave të ndryshme. Në këtë kohë vijnë të njëpasnjëshme edhe reagimet e diplomacisë britanike. Kështu Sir George W. Buchanan në letrën që i dërgonte Sir Edward Grey më 25 nëntor 1912 nga St. Petersburg e informonte atë për takimet e diplomatëve rusë me ata serbë dhe për kërkesat e këtyre të fundit. Në takimet serbo-ruse sipas W. Buchanan trajtoheshin edhe interesat e Serbisë për zgjerim në kurriz të shqiptarëve.

Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë nuk ishte ndonjë akt i papritur për Fuqitë e Mëdha. Britania e Madhe priste se shqiptarët do ta ndërmermin një hap të tillë sidomos pasi që ata u rrezikuan edhe më shumë pas krizës dhe luftërave ballkanike.

Kjo situatë shkaktoi shqetësime dhe reagimin e Britanisë së Madhe e cila ishte shumë e brengosur për shkak të mundësisë së destabilizimit dhe daljes jashtë kontrollit të situatës në Evropën Juglindore. Shfaqja e brengosjes së Londrës zyrtare shihet edhe në letrat dhe telegramet e konsujve dhe ambasadorëve të Mbretërisë së Bashkuar që i dërgonin qeverisë së tyre në Londër. Diplomacia angleze kishte analizuar dhe kishte nxjerrur përfundime për strategjinë dhe pretendimet e ushtrive ballkanike. Diplomatët britanik shprehen edhe për problemin shqiptar "Autonomia e Shqipërisë do të jetë e garantuar dhe e kontrolluar ekskluzivisht prej gjasthë Fuqive nën sovranitetin ose suzeranitetin e Sulltanit".

Sipas autorit, Shqipëria ishte vendi ku gërshetoheshin interesat e Fuqive të Mëdha. Prandaj, Britania e Madhe kishte zhvilluar bisedime të shumta me aleatët e saj dhe fuqitë e tjera të interesuara mbi gjendjen në Ballkan. Por hapin konkret për zgjidhjen e çështjes i hodhi Eduard Grey më 21 Nëntor 1912, në takimin që pati me ambasadorin Gjerman në Londër, princin Lichnovsky. Në këtë takim, Eduard Grey propozoi tre çështjet thelbësore që Fuqitë e Mëdha duhet të vinin në marrëveshje për ruajtjen e paqes evropiane:

"1) Mundësia e krijimit të një shteti shqiptar autonom dhe kufijtë që duhet të ketë; 2) Metodot dhe konditat e sigurimit të Serbisë në Adriatik; 3) Çështja e ishujve të Egjeut".

Vendimet e Konferencës duhet që t'u nënshtroheshin aprovimit të qeverive përkatëse dhe do të prodhonin efekte juridike vetëm pas aprovimit. Prandaj, marrëveshjet e arritura ambasadorët i përcollën qeverive respektive, të cilat i aprovuan brenda tre ditëve. Kështu më 20 dhjetor 1912, Eduard Grey, i ngarkuar nga konferenca, dha komunikatën zyrtare të aprovimit të vendimeve nga Fuqitë e Mëdha. Për pasojë, kjo datë konsiderohet si data që Fuqitë e Mëdha njohën në parim krijimin e shtetit shqiptar të pavarur.

Si rezultat i përpjekjeve të E. Greyt u gjend rruga e afimit të pikëpamjeve dhe më 29 korrik të vitit 1913, konferenca aprovoi projektin austro-hungarez dhe italian.

Në vazhdim autori flet për qëndrimin e diplomacisë britanike ndaj kufirit verilindor të Shqipërisë si dhe për qëndrimin e Britanisë së Madhe ndaj kufirit me Greqinë ku jepen të dhëna me interes për fatin që po i caktohej popullit dhe shtetit shqiptar.

Duke lexuar studimin monografik “Britania e Madhe dhe çështja shqiptare 1875-1913” të Prof. dr. Frashër Demaj mësojmë se ngjarjet në Ballkan në gjysmën e dytë të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX, morën ato kahje që tashme dihen. Kjo që rrjedhojë e luftës kundër Perandorisë Osmane, por edhe e shprehjes së interesave shoviniste të qarqeve të caktuara ballkanike si dhe të Fuqive të Mëdha, të cilat e penguan popullin shqiptar të realizonte aspiratat shekullore për shtet të pavarur në kufijtë etnik.

Në mënyrë të argumentuar, të mbështetur në dokumente të shumta arkivore, por edhe të pa shfrytëzuara deri më tani si dhe në burime të botuara e të pa botuara, Prof. dr. Frashër Demaj ka ditur të paraqesë qartë fokusimin e diplomacisë britanike në raport me dhe ndaj çështjes shqiptare. Prandaj, ky studim monografik është shkruar në mbështetje të një dokumentacioni të pastër historik, të burimeve arkivore të pashfrytëzuara deri më sot, të veprave studimore, akteve diplomatike, të proveniencave të ndryshme që kanë të bëjnë me temën bosht që trajton autori. Me këtë rast nuk mund të mos veçohet qëndrimi kritik i autorit ndaj literaturës dhe burimeve të shfrytëzuara. Ai këto dokumente i ka shfrytëzue dhe i ka trajtue me objektivitet shkencor dhe kritik.

Studimi monografik “Britania e Madhe dhe çështja shqiptare 1875-1913” e Frashër Demaj, është kontribut i pa diskutueshëm për historiografinë tonë në përgjithësi e për historinë e marrëdhënieve diplomatike në veçanti. Botimi i kësaj vepre është një eveniment me rëndësi jo vetëm për studiues të historisë dhe të historisë së diplomacisë e të studentëve të historisë, por edhe për një shtresë shumë më të gjerë lexuesish, aq më tepër kur kihet parasysh edhe fakti se publikime të tilla na mungojnë.